



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjeto Më/Dana <u>11.03.2011</u> vit/god.			
Nr.l organit Org.broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vendnost
<u>01-013/299</u>			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipal Vitina

Në mbështetje të nenit **12 par.2** idhur me nenin 58 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr 03/L-040 („G.Z. e Republikës së Kosovës” Nr 28/2008), si dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 4.par.2, 8, 15 dhe 16 të Ligjit për Shpronësimin e pronës së Palujtshme ,conform nenit 5.par 1. lidhur me nenin 22.par 2 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.02-013/5165 të dates 18.11.2008 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur me 28.02.2011 miraton këtë ;

VENDIM

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM-Për ndërtimin e trases së linjes 110kv. Drejtimi NS Ferizaj 2-Gjilan 5, mbi ngastrat në zonat kadastrale Ramjan, Katundi i Ri, Terpeze, Ballance dhe Zhiti.

Neni 1.

Me këtë propozim-vendim propozohet të bëhet shpronësimi i pjesëve te ngastrave kadastrale për zonat Ramjan,Katundi i Ri, Terpezë,Ballancë dhe Zhiti nëpër të cilat do të kaloj largëpërquesi 110 kv NS Ferizaj 2-Gjilani 5.

Neni 2.

Kompenzimi për ngastrat e ekspropriuara për te gjitha ngastrat kadastrale neper te cilat kalon largëpërquesi 110 kv dhe demet e shkaktuara gjate puneve do te bëhen nga subjekti kerkuaes. në kete raste KOSTT-I.

Neni 3.

Ngastrat kadastrale të cilat janë objekt i shpronësimit do të caktohen në bazë të projektit të paraqitur nga subjekti kërkues i shpronësimit, në mënyrë detale në vendimin preliminarë dhe ate prfundimtar.

Neni 4.

Per zbatimin e ketije Vendimi, do të kujdeset Drejoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë- sektori i pronësisë.

Neni 5.

Ky vendim fujzohet në ditën e miratimit në Kuvendin Komunal të Vitisë.

Kryetari Kuvendit të Komunës së Viti
Skenderbe Hebibi

